

Shtojca 2 :

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përherëshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PUKË

KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përherëshëm për Ekonomi dhe Financë

(Adresa, _____ nr. Tel _____, e-mail _____)

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 2 datë 24.02. 2025

Nr 374/17 Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim “PËR NJË SHITESË NË VKB NR 64 DATË 27.12.2024, PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2025 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2025-2027”

Analiza ligjore: Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Per Vetëqeverisjen Vendore“, dhe në zbatim të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore“, te ligjit 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar ,të ligjit 10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin“ të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore „“ i ndryshuar Udhezimin e Ministrisë Ekonomise dhe Financave nr 23 datë 30.07.2018 “Për Procedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor afat-mesem të Njësive të Vetqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 3 datë 28.02.2024 “ Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027”, udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 8 datë 05.07.2024 “ Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2025-2027” Rakordimin përfundimtarë me degën Thesarit datë 28.01.2025 “Të ardhurat dhe granti i trashëguar nga viti 2024 për vitin 2025”

Situata aktuale e funksionit: Me Rakordimin përfundimtarë me degën Thesarit datë 28.01.2025 “Të ardhurat dhe granti i trashëguar nga viti 2024 për vitin 2025” jane : 80670.514 leke

Situata financiare : Bashkia Puke, drejtorja e Financave ka bere rakordimin përfundimtarë me degën Thesarit datë 28.01.2025 “Të ardhurat dhe granti i trashëguar nga viti 2024 për vitin 2025” jane : 80670.514 leke. Ky buxhet do te perdoret sipas pikave 1/a dhe 1/b.

Monitorimi dhe raportimi : Komisioni i Ekonomisë dhe Financave dhe të gjithë këshilltarët dp të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme drejtorinë e Finances ose Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: Programi Buxhetor Afatmesem 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor per vitin 2025 impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të bashkisë Pukë

A është objekt i konsultimit publik: jo

Komisioni i Përhershëm për “Ekonomi dhe Financë”, i mbledhur me datën 24.02.2025 shqyrtoi projekt vendimin nr. 1 datë 11.02.2025, relacionin e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për “ndryshimin e VKB nr.64 date 27.12.2024 paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,


Komisioni me shumicë votash,


VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në procesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Dhitan Asani 
(emri, mbiemri, firma)

Erjona Gjokaj 
(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Sekretar i Komisionit

Datë 24.02. 2025